



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 946/ Prot.

Tiranë, më 30.06.2021

VENDIM

Nr. 49, datë 30.06.2021

PËR

MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROCEDURAVE TË PRANIMEVE TË
STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË NË PROGRAMET E STUDIMEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË UST

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 6 datë 25/06/2021 “Për miratimin e kalendarit për procesin e aplikimit dhe rregjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2021-2021”, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 30/06/2021,

VENDOSI:

1. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda datës **06 Gusht 2021** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurojnë në programet përkatëse të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe ia përcjell dy njësive kryesore dhe i afishon në mjediset e tyre e në faqen zyrtare elektronike.
2. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkurset e pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë **12, 13, 14, 16, 17 Gusht 2021 nga ora 09:00 deri në 15:00**.
3. Dokumentat që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore.
4. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit brenda datës **19 Gusht 2021** shpall listat e kandidatëve të regjistruar për konkurset e pranimit.
5. Datat e zhvillimit të konkurseve të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes janë **20-23 Gusht 2021**.

6. Datat e zhvillimit të konkurseve të pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë **24-26 Gusht 2021**.
7. Rregulloret e konkurseve të pranimit, testet praktike, kartela mjekësore gjenden në faqen zyrtare të UST.
8. Fatura e tarifës së konkurimit publikohet në datën **06 Gusht 2021** pas miratimit nga Bordi i Administrimit të UST-së.
9. Konkursi do të zhvillohet duke u bazuar në Rregulloren “*Mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga COVID-19*”.
10. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në datat **24-25 Gusht 2021** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit pranë **Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit**.
11. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda datës **29 Gusht 2021**, afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre të maturës.
12. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në datë **30 Gusht 2021** ngarkon një kopje elektronike e këtyre listave në portalin U-Albania.
13. Regjistrimi në Raundin e I-rë të kandidatëve fitues në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë në UST do të zhvillohet në datat **02 Shtator 2021 – 15 Shtator 2021 (7 faza / 48 orëshe)**.
14. Kriteret e pranimit, kuotat e pranimit, testet e konkursit së bashku me rregulloren e përkatëse si dhe plani mësimor për ciklin e parë të studimeve publikohen në faqen zyrtare të UST-së dhe Portalin U-albania.
15. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi dhe marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e gjithë procedurave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022, Administratori i UST-së, Zv/Rektorët, Dekanatet e Fakulteteve, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studëntët.
16. Ky vendim shpallet në faqen zyrtare të UST-së.
17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

